

# LIGJ PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen mënyra, kushtet dhe procedura për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe format përmes së cilave realizohen; financimi, evidenca dhe mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe çështje të tjera me rëndësi për bashkëpunimin ndërkomunal.

### Neni 2

(1) Bashkëpunim ndërkomunal, në kuptim të këtij ligji, është bashkëpunim që vendoset ndërmjet dy ose më shumë komunave për kryerjen në mënyrë më efikase dhe më ekonomike të kompetencave të komunave të verifikuara me ligj dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta.

(2) Me bashkëpunimin ndërkomunal nënkuptohet edhe kryerja e punëve të përcaktuara me kompetencë të komunave nga ana e një komune për llogari të një ose më shumë komunave në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet komunave.

### Neni 3

Komunat në mënyrë të pavarur dhe vullnetarisht, në pajtim me këtë ligj ose me ligj tjetër, vendosin për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal në realizimin e kompetencave të tyre.

## II. VENDOSJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

### Neni 4

(1) Bashkëpunimi ndërkomunal vendoset për shkak të kryerjes së në mënyrë të përbashkët të punëve me kompetencë të komunave, kryerjes së punëve të përbashkëta dhe realizimin e interesave dhe qëllimeve të përbashkëta.

(2) Për realizimin e interesave dhe qëllimeve të përbashkëta në zbatimin e kompetencave, komunat bashkojnë mjete financiare, materiale dhe të tjera.

(3) Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal merr çdo këshill i komunave me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

### Neni 5

(1) Propozim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal paraqet kryetari i komunës ose anëtari i këshillit të komunës.

(2) Iniciativë për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal mund të paraqesin së paku 10% e zgjedhësve të komunës.

(3) Propozimi përkatësisht iniciativa nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni përmban qëllimin e bashkëpunimit, kompetencën për të cilën parashtrihen, formën përmes së cilës realizohet bashkëpunimi, implikimet e mundshme financiare për bashkëpunim, si dhe çështje të tjera me rëndësi për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

(4) Propozimi përkatësisht iniciativa i dorëzohet këshillit të komunës.

(5) Për propozimin i cili nuk është parashtruar nga kryetari i komunës, përkatësisht për iniciativën, mendim jep kryetari i komunës.

## Neni 6

(1) Këshilli i komunës vendos për propozimin, përkatësisht iniciativën nga neni 5 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në bazë të vlerësimit të bërë paraprakisht për nevojën e vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal.

(2) Këshilli i komunës është i detyruar që debatin për iniciativën nga neni 5 paragrafi 2 të këtij ligji, ta mbajë më së voni në afat prej 90 ditësh pas dorëzimit të iniciativës dhe t'i informojë qytetarët për vendimin e tijve.

(3) Nëse këshilli i komunës e pranon propozimin, përkatësisht iniciativën për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, verifikon propozim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

(4) Propozimi nga paragrafi (3) të këtij neni i dorëzohet komunës ose komunave me të cilat propozohet vendosja e bashkëpunimit ndërkomunal.

## Neni 7

(1) Këshilli i komunës ose i komunave të cilave u është dorëzuar propozimi për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal nga neni 6 paragrafi (3) të këtij ligji, vendos për vendosjen e bashkëpunimit të propozuar më së voni në afat prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

(2) Për propozimin për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal nga neni 6 paragrafin (3) të këtij ligji mendim jep kryetari i komunës së komunës së cilës i është parashtruar propozimi.

## Neni 8

(1) Këshillat e komunave, të cilat e kanë pranuar propozimin, përkatësisht iniciativën për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal formojnë komision të përbashkët për përgatitjen e propozim-akteve me të cilat themelohen ose formohen format përmes të cilave do të realizohet bashkëpunimi ndërkomunal.

(2) Komisioni i përbashkët nga paragrafi (1) të këtij neni propozim-aktet i përgatit në bazë të analizës së bërë paraprakisht.

(3) Komisioni i përbashkët nga paragrafi (1) të këtij neni përbëhet nga numri i njëjtë i anëtarëve të propozuar nga komunat të cilat vendosin bashkëpunim ndërkomunal.

## III. FORMAT E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

### 1. Realizimi i bashkëpunimit ndërkomunal

## Neni 9

(1) Bashkëpunimi ndërkomunal mund të realizohet përmes:

a) formimit të trupave për bashkëpunim ndërkomunal:

-trup punues i përbashkët dhe komision;

-trup i përbashkët administrativ;

b) themelimit të shërbimeve të përbashkëta publike:

-ndërmarrje e përbashkët publike;

-institutcion i përbashkët publik.

(2) Bashkëpunimi ndërkomunal mund të realizohet edhe përmes lidhjes së marrëveshjeve

për:

-bashkimin e mjeteve financiare, materiale dhe të tjera;

dhe

-kryerjen e punëve të përcaktuara nga ana e një komune për një ose më shumë komuna të tjera.

## **2. Trupa punues të përbashkëta dhe komisione**

### Neni 10

(1) Dy ose më shumë komuna mund të formojnë trupa punues të përkohshme ose të përhershme dhe komisione për shqyrtimin e çështjeve të përcaktuara nga kompetenca e kryetarit të komunës ose të këshillit të komunës.

(2) Për formimin e trupit të përbashkët punues ose komisionit për shqyrtimin e çështjeve të caktuara me kompetencë të kryetarit të komunës, vendos kryetari i komunës përkatësisht për çështjet me kompetencë të këshillit të komunës vendos këshilli i komunës.

(3) Trupat e përbashkët punues dhe komisionet shqyrtojnë çështje dhe iniciojnë tëharrjen e vendimeve nga ana e organeve të komunave të cilat janë me interes të përbashkët në zbatimin e kompetencave të komunave.

(4) Trupa të përbashkët punues dhe komisione formohen dhe për shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e bashkëpunimit profesional të administratave komunale në zbatimin e kompetencave të komunave.

## **3. Trupi i përbashkët administrativ**

### Neni 11

Trup të përbashkët administrativ mund të formojnë dy ose më shumë komuna, në pajtim me Ligjin për vetadministrimin lokal, e për zbatimin e kompetencave të veçanta të komunave të përcaktuara me ligj.

### Neni 12

(1) Të drejta dhe obligimet e ndërsjella të komunave të cilat kanë formuar trup të përbashkët administrativ rregullohen me marrëveshje.

(2) Marrëveshjen nga paragrafi (1) të këtij neni e lidhin kryetarët e komunave të cilat kanë formuar trup të përbashkët administrativ.

(3) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) të këtij neni posaçërisht verifikohen edhe çështjet në vijim:

-përcaktimi i nevojave veçanta dhe të përbashkëta në zbatimin e kompetencave të veçanta të komunave;

-zgjedhja e udhëheqësit të trupit të përbashkët administrativ nga ana e kryetarëve të komunave të cilat e kanë formuar, në bazë të konkursit publik;

-mënyra e sistematizimit të vendeve punuese të trupit të përbashkët administrativ; dhe

-përgjegjësia e udhëheqësit të trupit të përbashkët administrativ para kryetarëve të komunave të cilat i kanë formuar.

### Neni 13

(1) Trupi i përbashkët administrativ kryen punë profesionale, normative-juridike, përmbaruese ose administrative-mbikëqyrëse në pajtim me nevojat e veçanta dhe të përbashkëta zbatimin e kompetencave të komunave të cilat e formojnë trupin e përbashkët administrativ.

(2) Trupi i përbashkët administrativ mund të formohet si sektor i përbashkët, seksion i përbashkët ose njësi projektuese e përbashkët.

#### Neni 14

(1) Trupi i përbashkët administrativ punët për të cilat është formuar i kryen në emër dhe për llogari të komunave të cilat e kanë formuar.

(2) Udhëheqësi i trupit të përbashkët administrativ për punën e vet dhe për punën e trupit të përbashkët administrativ i paraqet raport kryetarit të komunës dhe këshillit të komunave në çdo gjashtë muaj.

(3) Trupit të përbashkët administrativ nuk mund t'i barten të drejtat, kompetencat dhe obligimet e organeve të komunave të cilat e kanë formuar.

#### Neni 15

Selia e trupit të përbashkët administrativ është në selinë e komunës me numër më të madh të banorëve, nëse komunat nuk merren vesh ndryshe.

#### Neni 16

Pjesëmarrja e komunave në financimin e trupit të përbashkët administrativ bëhet proporcionalisht me llojin dhe vëllimin e punëve nga kompetenca e secilës komunë, nëse komunat nuk merren vesh ndryshe.

#### Neni 17

Kryetari i komunës së secilës komunë e përcjell kryerjen e punëve nga fushëveprimi i trupit të përbashkët administrativ, e të cilat u dedikohen punëve nga kompetencat e tij.

### **4. Ndërmarrja e përbashkët publike**

#### Neni 18

(1) Ndërmarrja e përbashkët publike themelohet për kryerjen e veprimtarisë me interes publik dhe me rëndësi lokale.

(2) Ndërmarrja e përbashkët publike themelohet në procedurën e verifikuar me ligj.

(3) Ndërmarrja e përbashkët publike themelohet me vendim që miratohet nga ana e këshillave të komunave në tekstin e njëjtë, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të çdo komune, themeluese të ndërmarrjes së përbashkët publike.

(4) Për ndërmarrjen e përbashkët publike kryetarët e komunave lidhin dhe nënshkruajnë marrëveshje me të cilat i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

(5) Me vendimin për themelimin të ndërmarrjes së përbashkët publike veçanërisht verifikohet:

-veprimtaria;

-firma dhe selia;

-shuma e mjeteve për themelimin dhe mënyra e sigurimit të tyre;

-organizimi i ndërmarrjes së përbashkët publike;

-mënyra e zbatimit të vendimeve të organeve të ndërmarrjes së përbashkët publike;

-përgjegjësia e ndërmarrjes së përbashkët publike për obligimet në qarkullimin juridik me persona të tretë;

-afati i miratimit të statutit dhe emërimi i organeve të ndërmarrjes së përbashkët publike;

-emërimi i personit i cili do t'i udhëheqë punët e ndërmarrjes deri në konstituimin e saj;  
-numri, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtues;  
-mënyra e zgjedhjes së drejtorit të ndërmarrjes së përbashkët publike; dhe  
-përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së këshillit mbikëqyrës.

#### Neni 19

Selia e ndërmarrjes së përbashkët publike është në selinë e komunës e cila ka numër të madh, përkatësisht numër më të madh të shfrytëzuesve të shërbimeve publike, nëse themeluesit nuk merren vesh ndryshe.

#### Neni 20

Shuma e mjeteve për themelimin të ndërmarrjes së përbashkët publike përcaktohet në buxhetet e komunave në korrelacion me përqindje proporcionalisht me numrin e shfrytëzuesve të shërbimeve publike, nëse themeluesit nuk merren vesh ndryshe.

#### Neni 21

Personi i cili do t'i udhëheqë punët deri në konstituimin e ndërmarrjes së përbashkët publike emërohet me propozim të këshillit të komunës, themeluese, në selinë e së cilës do të jetë selia e ndërmarrjes së përbashkët publike.

#### Neni 22

(1) Ndërmarrja e përbashkët publike aktet për të cilat komunat, themeluese të ndërmarrjes së përbashkët publike japin pëlqim, ua dërgojnë këshillave të komunave, njëkohësisht edhe në tekstin identik.

(2) Pajtueshmëria e akteve të ndërmarrjes së përbashkët publike jepet me miratimin e aktit veças për dhënien e pëlqimit nga secili këshill i komunave, themeluese të ndërmarrjes së përbashkët publike.

(3) Akti për të cilin jepet pëlqimi konsiderohet i miratuar me dhënien e pëlqimit nga ana e të gjitha këshillave të komunave, themeluese të ndërmarrjes së përbashkët publike.

#### Neni 23

(1) Komunat, themeluese të ndërmarrjes së përbashkët publike mund të ndërmarrin masa të verifikuara me ligj për sigurimin e kushteve për punën pa pengesa të ndërmarrjes publike.

(2) Për ndërmarrjen e masave në rastet e verifikuara me ligj, këshillat e komunave miratojnë akt identik.

(3) Akti miratohet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të secilës komunë, themeluese të ndërmarrjes së përbashkët publike.

### **5. Institucioni i përbashkët publik**

#### Neni 24

(1) Institucioni i përbashkët publik themelohet për kryerjen e veprimtarisë me interes publik me rëndësi lokale nga sfera e arsimit, kulturës, mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve dhe në veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj.

- (2) Institucioni i përbashkët publik themelohet me procedurën e verifikuar me ligj
- (3) Për themelimin e Institucionit të përbashkët publik, kryetarët e komunave lidhin dhe nënshkruajnë marrëveshje me të cilën i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

#### Neni 25

- (1) Institucioni i përbashkët publik themelohet me vendim që miratohet nga ana e këshillave të komunave, themeluese të institucionit të përbashkët publik në tekst identik.
- (2) Vendimi për institucionin e përbashkët publik miratohet me shumë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të çdo komune, themeluese të institucionit të përbashkët publik.

#### Neni 26

Me vendimin për themelimin e institucionit të përbashkët publik verifikohet veçanërisht:

- emri i themeluesve;
- emri dhe selia e institucionit;
- veprimtaria e institucionit;
- mjetet të cilat themeluesit i kanë siguruar për themelim dhe fillimin me punë të institucionit dhe mënyra e sigurimit të mjeteve;
- burimet e përhershme, mënyra dhe kushtet për sigurimin e mjeteve për punë të institucionit;
- të drejtat dhe obligimet e themeluesit në kuptim të kryerjes së së veprimtarisë, përkatësisht kryerjes së punëve të institucionit;
- të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të institucionit dhe themeluesit;
- koha për të cilën është themeluar institucioni;
- të drejtat, obligimet dhe detyrimet e institucionit në qarkullimin juridik;
- përgjegjësia e themeluesve për borxhet e institucionit;
- personi që do t'i kryejë punët për përfaqësimin dhe prezantimin e institucionit dhe autorizimet e tij në qarkullimin juridik;
- organizimi i institucionit;
- emërimi i anëtarëve të organit të udhëheqjes;
- afati për miratimin e statutit dhe për emërimin e drejtorit;
- mënyra e dispozicionit me tepricën e të hyrave mbi të dalat dhe mënyra e mbulimit të mangësisë së mjeteve për punën e institucionit;
- personi që i kryen punët deri në konstituimin e institucionit;
- numri, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së organit drejtues;
- mënyra e zgjedhjes së drejtorit; dhe
- përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së organit për mbikëqyrje.

#### Neni 27

Personi që do t'i udhëheqë punët deri në konstruktimin e institucionit emërohet me propozimin e këshillit të komunës, themeluesi në cilën seli do të jetë selia të institucionit të përbashkët publik, nëse themeluesit nuk vendosin ndryshe.

#### Neni 28

- (1) Komunat, themelues të institucionit të përbashkët publikë mundën të ndërmarrin masa të verifikuara me ligj për sigurimin e kushteve për punë të pa pengesa të institucionit publik.
- (2) Për ndërmarrjen e masave në raste të verifikuara me ligj këshillat e komunave miratojnë akt identik.

(3) Akti miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të çdo komune, themeluese e ndërmarrjes publike të përbashkët.

## **6. Kryerja e punëve të caktuara nga ana e një komune për një ose më shumë komuna të tjera**

### Neni 29

(1) Për kryerjen e punëve të caktuar nga kompetenca e komunave nga ana e një komune për llogari të një ose më shumë komunave të tjera lidhet marrëveshje.

(2) Marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni e lidhin kryetarët e komunave me marrjen e vendimeve paraprake nga ana e këshillave të komunave.

(3) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen:

-komuna e cila i kryen punët në kompetencë të komunës ose komunave për të cilat kryen punët;

-lloji i punëve;

-lloji dhe lartësia e kompensimit për kryerjen e punëve;

-kohëzgjatja e kryerjes së punëve;

-kushtet dhe procedura për pushimin e marrëveshjes, dhe

-çështje të tjera.

## **7. Bashkimi i mjeteve financiare, materiale dhe të tjera**

### Neni 30

(1) Komunit mund t'i bashkojnë mjetet financiare, materiale dhe të tjera për realizim të projekteve të përbashkëta në kryerjen e kompetencave të veta, në pajtim me këtë dhe ligj tjetër.

(2) Për bashkimin e mjeteve financiare, materiale dhe të tjera lidhet marrëveshje.

(3) Marrëveshjen nga paragrafi (2) të këtij neni e lidhin kryetarët e komunave të cilat i bashkojnë mjetet financiare, materiale dhe të tjera me marrjen e vendimeve paraprake të këshillave të komunave.

(4) Marrëveshja nga paragrafi (2) i këtij neni përmban veçanërisht:

-komunit të cilat i bashkojnë mjetet dhe resurset;

-lloji dhe lartësia e mjeteve të cilat bashkohen;

-dedikimi i mjeteve të cilat bashkohen;

-mënyra e dispozicionit dhe udhëheqja me mjetet;

-mënyra e shpërndarjes së përfitimeve dhe rreziku;

-kushtet dhe procedura për pushimin e marrëveshjes, dhe

-çështje tjera.

## **IV. NXITJA, PËRCJELLJA DHE FINANCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL**

### **1. Nxitja e bashkëpunimit ndërkomunal**

#### Neni 31

Instrumentet për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal janë:

- grantet e pakthyeshme;

- financimi dhe bashkëfinancimi për përgatitjen e analizave dhe studimeve nga sferat të cilat janë me rëndësi dhe në interes më të madh për kryerjen e veprimtarisë në ato sfera, dhe

- instrumente të tjera në pajtim me ligjin.

## Neni 32

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund ta nxisë dhe përkrahë në mënyrë financiare bashkëpunimin ndërkomunal në dy ose më shumë komuna në sferat të cilat janë me rëndësi dhe interes më të gjerë për kryerjen e veprimtarisë në ato sfera.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e Ministrisë së Vetadministrimit Lokal me akte i përcakton veprimet me rëndësi dhe interes më të gjerë për të cilat do të mund të ndajë mjete financiare për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund ta nxisë dhe përkrahë në mënyrë financiare bashkëpunimin ndërkomunal të komunave sipas kriterëve themelore në vijim:

-kapacitetit administrativ dhe financiar të komunave për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj;

-përfitimeve të pritura nga bashkëpunimi ndërkomunal;

-numrit të komunave të cilat marrin pjesë në bashkëpunimin ndërkomunal, dhe

-mjeteve paraprakisht të siguruara nga burime të tjera. (4) Kriteret më të afërta për nxitjen dhe përkrahjen e bashkëpunimit ndërkomunal me akte i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e Ministrisë së Vetadministrimit Lokal.

(5) Mjetet për nxitjen dhe përkrahjen e bashkëpunimit ndërkomunal mund të planifikohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë në vitin paraprak për vitin e ardhshëm.

## **2. Komisioni për nxitjen dhe përcjelljen e bashkëpunimit ndërkomunal**

### Neni 33

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Komision për nxitjen dhe përcjelljen e bashkëpunimit ndërkomunal.

(2) Komisioni për nxitjen dhe përcjelljen e bashkëpunimit ndërkomunal:

-i ndjek format e vendosura të bashkëpunimit ndërkomunal;

-i shqyrton dhe jep mendime për raportin vjetor për realizimin e bashkëpunimit ndërkomunal;

-inicon ndryshime dhe plotësime të normativës ligjore e cila ndikon në bashkëpunimin ndërkomunal;

-jep mendim për propozim-aktet nga neni 32 paragrafi (2) dhe paragrafi (4) i këtij neni;

-publikon shembujt më të mirë të bashkëpunimit ndërkomunal, dhe

-shqyrton edhe çështje të tjera me rëndësi për bashkëpunimin ndërkomunal.

(3) Punët administrative për nevojat e Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni i kryen Ministria e Vetadministrimit Lokal.

### Neni 34

(1) Komisionin për nxitjen dhe përcjelljen e bashkëpunimit ndërkomunal e përbëjnë dy përfaqësues nga Ministria e Vetadministrimit Lokal dhe nga një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

(2) Në Komision nga një përfaqësues përcakton dhe secili nga këshillat për zhvillim të rajoneve malore dhe Bashkësia e Njësive të Vetadministrimit Lokal e Republikës së Maqedonisë.

(3) Kryetar i Komisionit është njëri nga përfaqësuesit e Ministrisë së Vetadministrimit Lokal

(4) Mënyra e punës së Komisionit rregullohet me rregullore.



### **3. Financimi i bashkëpunimit ndërkomunal**

#### Neni 35

Bashkëpunimi ndërkomunal financohen nga:

- buxhetet e komunave;
- donacionet dhe sponsorimet nga persona fizikë dhe juridikë dhe
- burime të tjera të të ardhurave të verifikuara me ligj.

### **V. EVIDENCA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL**

#### Neni 36

(1) Evidencë për bashkëpunimin ndërkomunal mban Ministria e Vetadministrimit Lokal.

(2) Komunat të cilat vendosin bashkëpunim ndërkomunal janë të detyruar ta informojnë Ministrinë e Vetadministrimit Lokal dhe t'i dorëzojnë aktet për bashkëpunimin e vendosur në afat prej 30 ditësh nga dita e bashkëpunimit të vendosur..

(3) Ministria e Vetadministrimit Lokal e përcakton përmbajtjen e formularit të evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe mënyrën e mbajtjes së saj.

### **VI. MBIKËQYRJA**

#### Neni 37

Mbikëqyrjen e bashkëpunimit të vendosur ndërkomunal e kryejnë komunat të cilat e kanë vendosur bashkëpunimin ndërkomunal.

#### Neni 38

(1) Për përcjelljen dhe koordinimin e bashkëpunimit ndërkomunal ndërmjet dy ose më shumë komunave mund të formohet trup koordinues.

(2) Trupi koordinues mund të formohet me aktin me të cilin vendoset bashkëpunimi ndërkomunal ose me vendime të këshillave të komunave në periudhën të realizimit të bashkëpunimit.

(3) Me aktin përkatësisht vendimet nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet:

- qëllimi për të cilin formohet;
- fushëveprimi;
- përbërja dhe numri i anëtarëve të trupit koordinues;
- koha për cilën formohet trupi koordinues, dhe
- çështje të tjera me rëndësi për realizimin e bashkëpunimit të vendosur ndërkomunal.

#### Neni 39

(1) Mbikëqyrjen e realizimit të këtij ligji kryen Ministria e Vetadministrimit Lokal.

(2) Ministria e Vetadministrimit Lokal përgatit dhe i dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë raport vjetor për realizimin e bashkëpunimit ndërkomunal.

## VII. SHPALLJA E AKTEVE PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMUNAL

### Neni 40

(1) Aktet për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal shpallen në Fletoren zyrtare të komunës, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Marrëveshja ose kontrata për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal shpallen në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

## VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 41

Komunat të cilat deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë vendosur bashkëpunim ndërkomunal, janë të detyruara t’ia dorëzojnë aktet për bashkëpunimin e vendosur ndërkomunal Ministrisë së Vetadministrimit Lokal, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### Neni 42

Aktet nga neni 32 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh, ndërsa aktet nga neni 36 paragrafi (3) i këtij ligji do të miratohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### Neni 43

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.